



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

01 Nr. 61- 9547 /16
Kaçanik, 30.03.2016

Në bazë të nenit 17 (h) lidhur me nenin 40.2 të Ligjit Nr. 03/I-040 – Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), të nenit 6.2 (i) lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.03.2016, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR TË ARSIMIT
PËR PERIUDHËN 2016-2018

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani Zhvillimor i Arsimit 01Nr. 61-9547/2016, me tekstin e mëtejme “ Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Kaçanikut për periudhën 2016-2018”.
2. Plani Zhvillimor i Arsimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, është hartuar nga drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, ku janë paraqitur objektivat dhe mënyra e realizimit të tyre.
3. Plani Zhvillimor i Arsimit është i përmbledhur në gjithsej 28 faqe, dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
4. Për zbatimin Planit Zhvillimor të Arsimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, do të përkujdesët. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante) dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi